

UDHËZIM
Nr. 33, datë 21.1.2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 24.9.2012 “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË SË TË DHËNAVE
PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA KONTROLLUESIT E MËDHENJ”**

Në mbështetje të shkronjës “f” pika 1 e nenit 31 dhe në bazë të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 21, datë 24.9.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në titullin e udhëzimit, togfjalëshi “kontrolluesit e mëdhenj” zëvendësohet me “subjektet përpunuese të mëdha”.

2. Në pikën 1, togfjalëshi “teknike dhe organizative” zëvendësohet me “teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

3. Përmbajtja e shkronjës “a” të pikës 2, ndryshohet si vijon:

“Subjekte përpunuese të mëdha janë kontrolluesit ose përpunuesit, të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar 6 e më shumë persona për të kryer përpunimin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve”.

4. Në pikën 4, akti nënligjor i referuar ““Udhëzimin nr. 2, datë 25.2.2010 “Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale””, zëvendësohet me ““Udhëzimin nr. 24 , datë 27.12.2012 “Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale””.

5. Në pikën 6, togfjalëshi “masave teknike, organizative dhe të sigurisë personale” zëvendësohet me “masave të sigurisë teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

6. Në pikën 7, togfjalëshi “i jashtëm (person fizik ose juridik)” hiqet nga përmbajtja.

7. Në pikën 13, fjala “platformës” zëvendësohet me fjalën “shërbimeve”.

8. Në pikën 14, termi “business continuity plan” hiqet nga përmbajtja.

9. Në pikën 17, togfjalëshi “masat teknike dhe organizative të nevojshme” zëvendësohet me “masat teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

10. Në shkronjën “b” të pikës 20, fjala “dhe personale” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe në lidhje me personelin”.

11. Në paragrafin “i” të shkronjës “c” të pikës 21, fjala “të personelit” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe në lidhje me personelin”.

12. Në shkronjën “c” të pikës 34, fjala “të personelit” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe në lidhje me personelin”.

13. Në pikën 38, togfjalëshi “që sjell dëme për të”, zëvendësohet me “në dëm të personit të kontaktit”.

14. Përmbajtja e pikës 41 ndryshon si vijon:

“Nëse nuk është e mundur, për arsye objektive, të zbatohet afati i përcaktuar në pikën 40, Komisioneri do të ofrojë një muaj shtesë për subjektin përpunues të të dhënave personale”.

Ky udhëzim hyn në fuqi në të njëjtën kohë me udhëzimin nr. 21, datë 24.9.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)